

**MBI NDËRHJRJET NË TREGUN E PARASË DHE NË TREGUN VALUTOR,  
GJATË TREMUJORIT TË DYTË TË VITIT 2022**

**1. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E PARASË, GJATË TREMUJORIT TË DYTË TË VITIT 2022**

**1.1. Operacione të tregut të hapur dhe faktorët që kanë ndikuar në mungesën e likuiditetit të sistemit bankar**

**Tabelë 1.** Veprimet e përkohshme të tregut të hapur (në miliardë lekë<sup>1</sup>) *Burimi: Banka e Shqipërisë.*

DATA	R/REPO njëditore	R/REPO njëjavore	R/REPO >1javë <3muaj	REPO njëditore
7-prill-22		31.01		
14-prill-22		34.70		
21-prill-22		36.54		
26-prill-22			4.67	
28-prill-22		28.37		
5-maj-22		28.54		
12-maj-22		30.22		
19-maj-22		33.94		
24-maj-22			6.76	
26-maj-22		30.56		
2-qershor-22		29.07		
9-qershor-22		27.17		
16-qershor-22		28.22		
23-qershor-22		27.08		
24-qershor-22			7.25	
30-qershor-22		27.74		

Në tremujorin e dytë të vitit 2022, ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë konsistuan në operacionet e tregut të hapur për injektim likuiditeti.

Injektimi mesatar ditor nëpërmjet operacioneve injektuese të likuiditetit me maturim 1-13 javë, ka qenë 44.0 miliardë lekë, kundrejt përkatësisht 30.4 miliardë lekë dhe 42.4 miliardë lekë në 3-mujorët e mëparshëm.


Kërkesa e bankave për likuiditet në operacionet e Bankës së Shqipërisë, ka ruajtur prirjen rritëse pothuaj gjatë gjithë periudhës, duke u luhatur nga 39 miliardë lekë në fillim të periudhës në 46.40

miliardë në fund të saj.

Në funksion të operacioneve për administrimin e likuiditetit të sistemit bankar, Banka e Shqipërisë ka përdorur instrumentin e saj kryesor, marrëveshjen e anasjelltë të riblerjes me maturim njëjavor për mesatarisht 30.3 miliardë lekë kundrejt 20.1 miliardë lekësh në periudhën paraardhëse ose 68.90% të injektimit total.

<sup>1</sup> Shifrat janë në vlerë likuiditeti.

Grafik 1. Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë, në periudhën 2016-2022 (me vlerë nominale)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

## **1.2 Përdorimi i operacioneve lehtësuese të përhershme**


Sistemi bankar ka përdorur instrumentin e depozitës në BSH në mënyrë të vazhdueshme për mesatarisht 6.84 mld lekë ,kundrejt 9.3 mld lekësh në 3-mujorin e parë të vitit.

Instrumenti i kredisë njëditore nuk është përdorur gjatë 3-mujorit të dytë të vitit 2022, pasi ishte përdorur vetëm në 5 raste për shumat 30-450 mln lekë në 3-mujorin e mëparshëm.

## **1.3 Operacionet strukturore për menaxhimin e likuiditetit të sistemit bankar dhe portofolin e Bankës së Shqipërisë**

Gjatë 3-mujorit të dytë të vitit 2022, portofoli i Bankës së Shqipërisë është rritur me 430 mln lekë pasi ra me 100 milionë lekë në 3-mujorin e mëparshëm. Vlera e portofolit është 65.9 miliardë lekë. Operacionet e Bankës së Shqipërisë kanë synuar mbajtjen e portofolit në nivele të pandryshuara gjatë 3-mujorit, rinovimin e pjesshëm të portofolit në tregun sekondar dhe rritje të pjesëmarrjes në një prej emetimeve 3-mujore. Janë maturuar në tregun primar 2.82 miliardë lekë bono thesari dhe janë blerë në 9 ankande 3.25 miliardë lekë bono thesari.

Grafik 2. Portofoli i BSH-së



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Pas rritjes së portofolit në 6 muajt e parë të vitit 2020, në periudhën pasuese, luhatjet e portofolit të Bankës së Shqipërisë kanë qenë minimale.

## 1.4 Përdorimi i operacioneve rregulluese

Gjatë periudhës nuk ka pasur operacione rregulluese.

## **2. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E BRENDSHËM VALUTOR, GJATË TREMUJORIT TË DYTË TË VITIT 2022**

### 2.1 Veprime me bankat e nivelit të dytë

Pas anulimit të 3 ankandeve në periudhën mars-prill, nga muaji maj, Banka e Shqipërisë ka zhvilluar 3 ankande për blerjen e valutës, sipas kalendarit të njoftuar më 21 dhjetor 2021.

#### **Kalendari i ndërhyrjeve - Viti 2022**

	<b>Data</b>	<b>Shuma Raundi I (në Euro)</b>
<b>1</b>	18/02/2022	5-8 mln
<b>2</b>	17/03/2022	<b>anuluar</b>
<b>3</b>	13/04/2022	<b>anuluar</b>
<b>4</b>	27/04/2022	<b>anuluar</b>
<b>5</b>	13/05/2022	5-8 mln
<b>6</b>	03/06/2022	5-8 mln
<b>7</b>	17/06/2022	5-8 mln
<b>8</b>	12/07/2022	5-8 mln
<b>9</b>	22/07/2022	5-8 mln
<b>10</b>	05/08/2022	5-8 mln
<b>11</b>	19/08/2022	5-8 mln

<b>12</b>	18/10/2022	5-8 mln
<b>13</b>	18/11/2022	5-8 mln
<b>14</b>	05/12/2022	5-8 mln
<b>15</b>	16/12/2022	5-8 mln

**Shënim: Me objektiv rritjen e rezervës valutore, gjatë vitit 2022, Banka e Shqipërisë synon të blejë 140-200 mln euro përmes ankandeve.**

Në lidhjen e mëposhtme mund të gjeni një informacion të përmbledhur mbi historikun dhe rezultatet e ndërhyrjeve të Bankës së Shqipërisë në tregun valutor:

**[https://www.bankofalbania.org/Tregjet/Operacionet\\_e\\_Bankës\\_së\\_Shqipërisë/Ndërhyrjet\\_në\\_tregun\\_valutor/](https://www.bankofalbania.org/Tregjet/Operacionet_e_Bankës_së_Shqipërisë/Ndërhyrjet_në_tregun_valutor/)**

## **2.2 Veprime me institucione të tjera**

Gjatë 3-mujorit, MFE-ja ka ulur shumën e marrëveshjeve SWAP të pamaturuara në 20.80 miliardë lekë kundrejt 24.40 miliardë lekëve në fillim të periudhës.

Marrëveshjet SWAP të pamaturuara paraqiten si më poshtë:

1. 40 mln euro në 30 nëntor 2022;
2. 79 mln euro në 29 dhjetor 2022;
3. 50 mln euro në 30 dhjetor 2022.

Gjatë 3-mujorit, Banka e Shqipërisë ka blerë 4.6 milionë euro nga programi IPA i MFE-së dhe 0.39 mln euro nga IBRD-ja, si dhe i ka shitur ASD-së 0.70 mln euro.